

02

Free movement for
workers

KAPITULLI 2

Liria e lëvizjes së punëtorëve

Lëvizja e lirë e punëtorëve është një nga parimet themeluese të Bashkimi Europian dhe e drejta e parë e arritur në procesin e ndërtimit të Bashkimit Europian.

Kjo liri i garanton çdo shtetasi të një vendi të BE-së të drejtën të zgjedhë lirisht vendin e punës dhe qëndrimin në çdo vend tjetër të Bashkimit Europian.

Kuadri ligjor i BE-së rregullon ushtrimin e kësaj të drejte dhe ndalon çdo lloj diskriminimi mbi bazë shtetësie sa i përket punësimit, shpërblimit dhe kushteve të punës dhe të punësimit.

Në veçanti, liria e lëvizjes së punëtorëve i garanton çdo shtetasi të BE-së:

- Të drejtën për të kërkuar punë në një vend tjetër;
- Të drejtën e punësimit pa patur nevojë për leje pune;
- Të drejtën për të banuar në vendin e punësimit;
- Të drejtën e trajtimit të barabartë me punëtorët vendas, përfshirë qasjen e barabartë në punësim, kushtet e punës, mbështetje sociale dhe taksim;
- Të drejtën e bashkimit familjar—të drejtën që bashkëshortët apo partnerët dhe fëmijët nën moshën 21 vjeçare të qëndrojnë me ta në vendin e punësimit dhe të marrin përfitimet që u takojnë familjarëve.

Për mbështetjen e punëtorëve që lëvizin në vende të tjera, vendet e BE-së kanë krijuar një sistem për koordinimin e sigurimeve shoqërore i cili u garanton qytetarëve njohjen dhe vazhdimin e të drejtës së pensionit apo përfitimeve të tjera shoqërore edhe kur punojnë dhe qëndrojnë në një vend tjetër nga vendi i tyre.

Kjo e drejtë u lejon qytetarëve që të lëvizin në një vend tjetër edhe pa ofertë pune duke u lejuar aty qëndrimin në atë vend për një kohë të arsyeshme dhe të mjaftueshme për gjetjen e një pune. Ajo gjithashtu u ofron atyre të drejtën të mbeten në vendin e punësimit: pas 5 vjetësh qëndrimi të pandërprerë qytetarët fitojnë të drejtën e lejes të qëndrimin të përhershëm.

Negociatat me BE-në për garantimin e lëvizjes së lirë të punëtorëve përfshijnë harmonizmin e kuadrit ligjor për aksesin në punësim dhe atë të skemave të mbështetjes sociale, përfshirë pensionet; dhe të qëndrimin në Shqipëri. Ajo duhet të garantojë aksesin në drejtësi në lidhje me të drejtën e punës të çdo qytetari të BE-së.

Shërbimet shqiptare të punësimit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në Sistemin Europian të Punësimit (EURES) i cili koordinon shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin mes shërbimeve kombëtare të punësimit.

Shqipëria duhet të fuqizojë kapacitetet administrative për zbatimin e parimit të mosdiskriminimit në akses në punësim, përfshirë të ruajtjes dhe portabilitetit të përfitimeve sociale të lidhura me punën, dhe të transparencës së informacionit për akses në tregun vendas për shtetasit e BE-së dhe familjarët e tyre, pavarësisht shtetësisë.

Anëtarësimi në BE do t'u hapë shqiptarëve mundësinë për t'u punësuar pa pengesa në çdo vend të BE-së. Ata do të kenë mundësi të konkurojnë në një treg shumë të madh dhe të shumëllojshëm pune. Shumë prej tyre do përfitojnë nga vendet e lira të punës në shumë sektorë të cilët BE nuk i përballon dot me fuqinë e tanishme punëtore. Për ilustrim, në gjysmën e parë të vitit 2024 kishte rreth 200

milione të punësuar në BE, ndërkohë që mbi 2,4 për qind e vendeve të punës ishin bosh—në vende si Holanda, Belgjika apo Austria niveli i vendeve të paplotësuara është më i lartë se 4 për qind.

Shtetasit shqiptarë do të gëzojnë lirinë të studiojnë, punojnë dhe dalin në pension në çdo vend të BE-së që dëshirojnë.

Grupe me interes për t'u përfaqësuar:

Shoqatat e punëtorëve; shoqatat e profesionistëve të lirë; shoqatat e tregtisë dhe industrisë; shoqatat e migrantëve; shërbimet e punësimit dhe ndërmjetësimit të punësimit.

Institucioni udhëheqës i negociatave:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Institucione kyçe të përfaqësuara në negociatë:

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore